

**STATUTI**  
**I**  
**URDHERIT TE STOMATOLOGUT TE SHQIPERISE**

Statuti i Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë (më tej Urdhri ose USSH) është i bazuar në Ligjin Nr. 127 datë 02.10.2014 "Për Urdhrit e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë", ne mbështetje të neneve 78 dhe 83.pika1.te Kushtetutes.

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi i ligjit**

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet juridike dhe etiko- profesionale të profesioneve, stomatologë dhe ndihmësstomatologë, si dhe organizimin e Urdhrit të Stomatologut.

**Neni 2**  
**Fusha e zbatimit**

Ky ligj zbatohet për të gjithë stomatologët dhe ndihmësstomatologët që e ushtrojnë këtë profesion në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 3**  
**Statusi**

Urdhri i Stomatologut në Republikën e Shqipërisë është ent publik, jobuxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesionistëve, stomatologë dhe ndihmësstomatologë, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre në funksion të publikut.

**KREU II**

**MISIONI DHE BUXHETI**

**Neni 4**  
**Misioni**

1. Misioni i Urdhrit të Stomatologëve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesioneve në fushën e stomatologjisë dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i profesionit të stomatologut.

2. Për të përmbushur misionin e tij, Urdhri i Stomatologëve ushtron këto kompetenca:

- a) jep dhe heq licencën individuale të ushtrimit të profesionit;
- b) vendos standarde etike dhe deontologjike, të detyrueshme për çdo stomatolog dhe monitoron zbatimin e tyre gjatë ushtrimit të profesionit;
- c) rivlerëson periodikisht kompetencën dhe performancën profesionale të anëtarit të Urdhrit të Stomatologëve përballë standardeve të vendosura;
- ç) nxit arritjen e standardeve të larta në edukimin dhe formimin profesional dhe etik të anëtarëve të Urdhrit;
- d) bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, institucione të tjera shkencore dhe arsimore për të siguruar standarde të larta në Edukimin e Vazhdueshëm Mjekësor, kualifikimet dhe specializimet pasuniversitare të Urdhrit;
- dh) krijon dhe mban Regjistrin Themeltar të Urdhrit, i cili është i ndarë në pjesë të veçanta për stomatologët dhe ndihmësstomatologët dhe menaxhon sistemin e administrimit dhe përditësimit të tij;
- e) mbron të drejtat e anëtarëve të Urdhrit, integritetin moral dhe profesional të tyre e të profesionit të stomatologut.

## **Neni 5**

### **Kriteret e anëtarësisë**

1. Janë anëtarë të Urdhrit të Stomatologut të gjithë stomatologët që ushtrojnë profesionin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë dhe përmbushin kriteret e mëposhtme:

- a) të jenë shtetas shqiptarë;
- b) të kenë diplomën e stomatologut, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë brenda apo jashtë shtetit, i njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- c) në momentin e kërkesës për anëtarësim, të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale;
- ç) të njohin dhe të zotohen me shkrim që do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutin dhe Kodin Etik dhe Deontologjik Stomatologjik.

2. Stomatologut, shtetas i huaj, që të ushtrojë profesionin si rezident në Shqipëri apo i atashuar në një institucion shëndetësor, ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit, i duhet edhe:

- a) leja e qëndrimit dhe leja e punës në Republikën e Shqipërisë; b) certifikata e mirësjelljes (*Good Standing Certificate*) nga urdhri/dhoma apo shoqata e stomatologëve të vendit të vet, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk ka masa ndëshkimore;
- c) njësimi (konvalidimi) i diplomës dhe certifikatave të specializimeve të kryera prej tij/saj;
- ç) rekomandimi nga një specialist vendas i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Stomatologut;
- d) njohja e gjuhës shqipe, e vërtetuar me dëshmi nga një autoritet i licencuar nga shteti. Stomatologu jorezident detyrimisht duhet të punojë me përkthyes.

3. Procedura e anëtarësimin dhe ndërprerjes së anëtarësisë përcaktohet në statutin e Urdhrit të Stomatologut, i cili miratohet nga Këshilli Kombëtar.

4. Ndihmësstomatologët regjistrohen në një regjistër të veçantë të Urdhrit. Ndihmësstomatologu për t'u regjistruar në Urdhriin e Stomatologut duhet të plotësojë këto kriteret:

a) të ketë një diplomë për ndihmësstomatolog, të njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin.

b) në momentin e kërkesës për anëtarësim, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale.

c) të njohë dhe të zotohet me shkrim që do të zbatojë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutin dhe Kodin Etik Deontologjik Stomatologjik.

Procedura e regjistrimit të ndihmësstomatologëve në urdhër përcaktohet në statutin e Urdhrit të Stomatologut.

5. Urdhri, me akte të veçanta, përcakton mënyrën e regjistrimit të anëtarëve, të evidentimit e të mirëmbajtjes së regjistrave, përmbajtjen e tyre dhe formën e shkresave, vërtetimeve e akteve të tjera, si dhe vulën e Urdhrit, në bazë të evidencës zyrtare.

## **Neni 6**

### **Detyrimet e anëtarëve të Urdhrit**

1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e stomatologut dhe të ndihmësstomatologut në sistemin e kujdesit shëndetësor, publik apo privat, në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Stomatologut dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit, të lëshuar nga ky organizëm.

2. Anëtari i Urdhrit ka këto detyrime:

a) të ushtrojë profesionin dhe të ketë sjellje profesionale në përshtatje me kërkesat dhe standardet e legjislacionit shqiptar në fushën e shëndetësisë, Statutin e Urdhrit të Stomatologut dhe Kodin Etik Deontologjik Stomatologjik.

b) të punojë pa ndërprerje për rritjen e standardeve profesionale dhe të cilësisë së kujdesit shëndetësor në institucionin ku punon dhe të marrë pjesë rregullisht në programet e edukimit në vazhdim mjekësor.

c) të paguajë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifat e regjistrimit, të dhënies së të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe shërbime të tjera administrative në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij.

## **Neni 7**

### **Bashkëpunimi**

1. Urdhri i Stomatologut, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë e institucionet në varësi të saj dhe me ministritë, institucionet qendrore dhe organizma të tjerë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi, publikë ose jopublikë.

2. Urdhri i Stomatologut bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor për kontrollin e zbatimit të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e shëndetësisë.

3. Urdhri i Stomatologut informon çdo 6 muaj ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë lidhur me anëtarësimet, gjykimet disiplinore dhe probleme të tjera me interes të ndërsjellë. Ky informacion publikohet edhe në faqen e internetit të Urdhrit.

4. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë bashkëpunon me Urdhrit e Stomatologut për hartimin e projektligjeve dhe të dokumenteve të rëndësishme në fushën e shëndetësisë.

## **Neni 8 Buxheti**

1. Urdhri i Stomatologut ka buxhetin e tij, të cilin e miraton Asambleja Kombëtare dhe e administron vetë në përputhje me rregullat financiare në fuqi. Burimet financiare të Urdhrit të Stomatologut janë:

- a) kuotizacionet e anëtarëve;
- b) tarifatat e regjistrimit dhe të dhënies së të drejtës individuale për ushtrimin e profesionit, vërtetime dhe dokumente të tjera, për të cilat urdhri mban evidencë zyrtare;
- c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

2. Të ardhurat e siguruara sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të këtij neni, Urdhri i Stomatologëve i përdor për të përmbushur misionin e tij në përputhje me statutin dhe me këtë ligj.

## **KREU III**

### **ORGANIZIMI DHE DREJTIMI**

## **Neni 9 Organet kryesore**

1. Organet kryesore të Urdhrit të Stomatologut janë:

- a) asambletë;
- b) këshillat;
- c) komisionet disiplinore;
- ç) presidentët e Urdhrit.

2. Zgjedhjet në organet e sipërpërmendura duhet të sigurojnë përfaqësim në masën 30 për qind për çdo gjini, në përputhje me ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri".

## **Neni 10 Asambletë**

1. Asambleja Kombëtare është organi më i lartë drejtues i Urdhrit dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e këshillave rajonale.

2. Mbledhja e Asamblesë Kombëtare thirret nga:

a) Presidenti i Këshillit Kombëtar; b) kur kërkohet nga 1/3 e të gjithë anëtarëve të Asamblesë.

3. Asambleja rajonale zgjedh këshillin rajonal.

4. Përbërja e anëtarëve të asamblesë rajonale dhe procedurat e zgjedhjes së tyre përcaktohen në Statutin e Urdhrit të Stomatologëve.

## **Neni 11 Këshilli Kombëtar**

1. Këshilli Kombëtar përbëhet nga 25 anëtarë, ndër të cilët 20 janë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja Kombëtare dhe 5 të tjerët janë: Presidenti i Urdhrit të Stomatologëve, zëvendësi i tij, një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, një përfaqësues nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit

Shëndetësor, një përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, të caktuar nga presidenti i Urdhrit në bazë të kriterëve të përcaktuara në statutin e Urdhrit.

2. Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:

- a) miraton strukturën e vet organizative dhe të këshillave rajonalë;
- b) zgjedh Presidentin e Urdhrit të Stomatologëve dhe zëvendësin e tij;
- c) cakton kuotizacionin dhe tarifat;
- ç) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar, duke përcaktuar fondet në administrimin e këshillave rajonalë;
- d) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;
- dh) mbikëqyr dhe ndërhyr në rregullimin e marrëdhënieve të punës të stomatologëve me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;
- e) miraton statutin, rregulloret e Urdhrit si dhe Kodin Etik dhe Deontologjik Stomatologjik.

## **Neni 12** **Këshilli rajonal**

1. Këshilli rajonal përbëhet nga 5 deri në 9 anëtarë, në varësi të numrit të anëtarëve të Urdhrit të Stomatologëve në qark. Anëtarët e këshillit propozohen dhe zgjidhen nga asambleja rajonale.

2. Rregullat e zgjedhjes së anëtarëve të këshillave rajonalë përcaktohen në statutin e Urdhrit.

3. Këshilli rajonal ka këto funksione:

- a) mbikëqyr dhe ndërhyr në rregullimin e marrëdhënieve të punës ndërmjet stomatologëve dhe ndihmësstomatologëve në sektorin publik dhe privat në qark;
  - b) administron buxhetin dhe të gjitha pasuritë e Urdhrit në nivel qarku;
  - c) cakton komisionin disiplinor në nivel qarku.
4. Zgjedhjet për Këshillin Rajonal bëhen çdo 5 vjet.

## **Neni 13** **Presidentët e Urdhrit**

1. Presidentët e Urdhrit zgjidhen me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar dhe ai rajonal midis jo më pak se 2 kandidaturave alternative, të cilat propozohen nga Asambleja Kombëtare.

2. Këshilli Kombëtar zgjedh Presidentin e Urdhrit të Stomatologut me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Mandati i presidentit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm njëherë.

3. Këshillat rajonalë zgjedhin presidentët përkatës të këshillave rajonalë. Mandati i tyre është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Kandidaturat për presidentë të Urdhrit të Stomatologut duhet të përmbushin këto kriterë:

- a) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;
- b) të kenë jo më pak se 15 vjet eksperiencë në profesion;
- c) të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizimi e drejtimi;
- ç) të mos jenë marrë ndaj tyre masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;
- d) të kenë kryer botime shkencore në fushën e stomatologjisë;

dh) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

5. Funkzioni i presidentëve të Urdhrit të Stomatologut është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik.

6. Presidentët e Urdhrit e përfundojnë mandatin e tyre përpara kohe në këto raste:

a) shkarkohen nga detyra me vendim të Këshillit Kombëtar ose këshillit rajonal, me jo më pak se dy të tretat e anëtarëve;

b) japin dorëheqjen;

c) dënohen me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;

ç) humbasin zotësinë e plotë për të vepruar;

d) bëhen të paafte për arsye shëndetësore për të kryer detyrat e tyre, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor.

7. Procedura e zgjedhjes, detyrat dhe kompetencat e presidentëve të Urdhrit të Stomatologut përcaktohen në Statutin e Urdhrit.

## **Neni 14** **Komisionet disiplinore**

1. Pranë këshillave rajonalë dhe Këshillit Kombëtar funksionojnë komisionet disiplinore, si organizma të gjykimit profesional. Komisioni disiplinor rajonal përbëhet nga 7 anëtarë të zgjedhur nga këshilli rajonal. Komisioni Disiplinor Kombëtar përbëhet nga 9 anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.

2. Mënyra e ngritjes dhe e funksionimit të komisioneve disiplinore përcaktohet në statutin e Urdhrit.

3. Komisioni verifikon dhe shqyrton ankesat e çdo personi për shkelje të Kodit Etik Deontologjik Stomatologjik, si dhe për gabime profesionale të anëtarëve të Urdhrit të Stomatologut.

4. Komisionet disiplinore, pranë këshillave rajonalë, ushtrojnë kompetenca disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre janë të apelueshme në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë.

## **Neni 15** **Masat disiplinore**

1. Komisioni disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara dhe seancës dëgjimore. Kur nuk kemi të bëjmë me një veprë penale dhe vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës, të Kodit Etik Deontologjik Stomatologjik ose ka bërë gabime teknike, komisioni jep këto masa:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) gjobë nga 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë deri 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ç) propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore, publike dhe private;

d) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologut deri në 3 vjet;

dh) përjashtim nga Urdhri i Stomatologut për një periudhë deri në 3 vjet;

2. Përveç masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, komisioni ka të drejtë t'u caktojë të ndëshkuarve, si masë plotësuese, kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese, të barabarta me 20 kredite.

3. Masat e sipërpërmendura disiplinore mund të shlyhen në qoftë se, brenda 1 viti nga dita e dhënies së tyre për shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të këtij neni, dhe brenda 3 vjetëve nga data e dhënies së tyre, për shkronjat "ç", "d" dhe "dh", të pikës 1, të këtij neni, ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

4. Gjoha e vendosur sipas shkronjës "c", të pikës 1, derdhet në Buxhetin e Shtetit.

## **Neni 16**

### **Ankimi**

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga komisioni disiplinor i këshillit rajonal paraqiten në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Stomatologut brenda 15 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.

2. Komisioni disiplinor, brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i komisionit disiplinor të Këshillit Kombëtar ankimohet në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

## **Neni 17**

### **Detyrat e Këshillit Kombëtar**

Këshilli Kombëtar udhëheq dhe mbikëqyr të gjithë veprimtaritë e Urdhrit. Për përmbushjen e misionit të tij, Këshilli:

1. Harton dhe miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe organizon mbikëqyrjen dhe zbatimin e tij.
2. Harton dhe miraton Statutin dhe Rregulloret e funksionimit të Këshillave dhe strukturave të tjera të Urdhrit;
3. Miraton strukturat organizative dhe administrative të Urdhrit në nivel kombëtar dhe rajonal;
4. Miraton buxhetin dhe administrimin e pasurive të Urdhrit;
5. Përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të profesioneve mjekësore në funksion të ushtrimit të lirë dhe autonom të profesionit;
6. Miraton strategjitë e zhvillimit të Urdhrit dhe me anë të strukturave të veta organizon zbatimin e tyre;
7. Sensibilizon dhe informon opinionin publik për misionin dhe funksionet e Urdhrit si dhe deklaron pozicionimet e tij për probleme dhe situata të veçanta sa i takon misionit dhe attributeve të tij;
8. Nxit dhe bashkëpunon me faktorë dhe aktorë të tjerë të sistemit për standarde të larta të edukimit dhe formimit profesional të mjekëve dhe përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor.

## **Neni 18**

### **Vendimet e Këshillit Kombëtar**

Vendimet e Këshillit Kombëtar janë të detyrueshme për të gjitha strukturat dhe nivelet e Urdhrit.

## **Neni 19**

### **Aparati Qendror i Këshillit Kombëtar**

Aparati Qendror i Këshillit Kombëtar koordinon dhe kontrollon veprimtaritë e Këshillave Rajonale, veprimtaritë tekniko-administrative dhe ekonomike-financiare të Urdhrit. Siguron dhe kontrollon zbatimin dhe respektimin e Ligjeve, si dhe të Statutit, Rregulloreve të Urdhrit. Siguron dhe kontrollon zbatimin e Vendimeve të Këshillit Kombëtar, si dhe;

1. Shqyrton dhe përcakton në Bordin Këshillimor kuotizacionet e anëtarësisë, pagat, honoraret, tarifatat e regjistrimit, anëtarësimin, tarifatat për Liçensën për ushtrimin individual të profesionit dhe pagesa të tjera të cilat i parashtron për vendimmarrje në Këshillin Kombëtar;
2. Organizon dhe mbikëqyr procesin e regjistrimit, anëtarësimin dhe administrimin e Regjistrimit të Stomatologeve në nivel kombëtar e rajonal;
3. Mbikëqyr veprimtaritë për pajisjen e stomatologeve me Liçensën për ushtrimin individual të profesionit dhe përcakton kriteret për lëshimin e saj;
4. Emëron ose miraton sipas kriterëve të specifikuar në këtë Statut, komisione apo grupe të tjera pune me karakter të përhershëm të cilat i miraton me Vendim të Këshillit Kombëtar;
5. Drejton dhe mbikëqyr sistematikisht veprimtaritë e Këshillave Rajonale;
6. Organizon veprimtari shkencore, trajnime e seminare kualifikuese për drejtues të strukturave të Urdhrit, anëtarë komisionesh dhe punonjës të tjerë;
7. I propozon Këshillit Kombëtar, anëtarë të Urdhrit për dekorime, vlerësime të ndryshme dhe shpërblime;
8. Organizon dhe mban marrëdhënie me organizma e forume ndërkombëtare dhe ratifikon në Këshillin Kombëtar marrëveshje dhe protokolle bashkëpunimi me to;
9. Nxjerr Buletinin e Urdhrit, si dhe botime të tjera;

## **Neni 20**

### **Bordi Këshillimor i Aparatit Qendror të Këshilli Kombëtar**

Bordi Këshillimor është organ këshillimor i Presidentit dhe përbëhet nga Zv. Presidenti, Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendësi i tij, Kryetari/ja e Degës Ekonomike- Financiare, Juristi, Presidenti i Këshillit Rajonal të US Qarku Tiranë



dhe një përfaqësues i Shoqatës së Stomatologëve.

Mbledhjet e Bordit mund të thirren nga Presidenti vet, ose me kërkesë të Aparatit, kur i duhet të shqyrtojë dhe konsultojë probleme për të cilat do të vendosë vet me Aparatin, ose do t'i paraqiten Këshillit Kombëtar vendimmarrje. Mbledhje e Bordit organizohen nga Sekretari i Përgjithshëm ose Zëvendësi i tij.

## **Neni 21**

### **Presidenti i Këshilli Kombëtar**

Presidenti i Këshillit Kombëtar ka këto detyrat dhe kompetenca:

- 1) Drejton dhe mbikëqyr të gjithë veprimtaritë e Urdhrit.
- 2) Nxjerr urdhëresa e udhëzime për zbatimin e Vendimeve të Këshillit Kombëtar dhe çështje të tjera për mbarëvajtjen e punës.
- 3) Thërret mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit Kombëtar dhe të Bordit Drejtues.
- 4) Thërret mbledhjet e jashtëzakonshme të asambleve apo këshillave rajonale.
- 5) Në kuadër të marrëdhënieve me institucionet e administratës shtetërore, si dhe organe e organizma të tjera brenda e jashtë vendit, përfaqëson Këshillin Kombëtar, shprehet dhe bën propozime në emër të tij. Në mungesë të tij, ia delegon këto kompetenca zëvendës Presidentit, Sekretarit të Përgjithshëm, zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm, apo një personi tjetër.
- 6) Propozon kandidatura për t'u zgjedhur, kooptuar ose shkarkuar në organet e Urdhrit si dhe bën propozime për dekorime, vlerësime, shpërblime, ndihma etj.
- 7) I autorizon të drejtën e nënshkrimit për Urdhrin zëvendës Presidentit, Sekretarit të Përgjithshëm, ose zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm.
- 8) Pasi t'i ketë shqyrtuar me Bordin Këshillimor, duke marrë në konsideratë edhe mendimet dhe sugjerimet këtij të fundit, emëron dhe shkarkon Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm, si dhe punonjësit e Aparatit që nuk janë të zgjedhur.
- 9) Midis dy mbledhjeve të Këshillit Kombëtar merr vendime në emër të tij. Këto Vendime i ratifikon në mbledhjen më të afërt të Këshillit, ose në të kundërt ato shfuqizohen.
- 10) Thërret grupe pune, apo individë për udhëzime, raportime, konsultime dhe detyra të ndryshme.
- 11) Thërret drejtues institucionesh, shërbimesh apo stomatologe, kur ka ndodhi të ndryshme në shërbimet e tyre, nga të cilët informohet për ngjarjet dhe sipas rastit i këshillon, i paralajmëron ose i relatton për proces disiplinor në Urdhrin e Stomatologeve, ose në institucionet sipas varësisë së tyre.

## **Neni 22**

### **Sekretari i Përgjithshëm**

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjësi kryesor për problemet tekniko-organizative të Këshillit Kombëtar dhe të Aparatit të tij. Ai mund të jetë mjek, jurist,

sociolog ose ekonomist.

Sekretari i Përgjithshëm kryen këto detyra:

1. Drejton dhe kontrollon mbarëvajtjen e punës në Aparatin Qendror të Këshillit Kombëtar.
2. Mban kontakte me këshillat rajonale dhe koordinon veprimtarinë e tyre.
3. Kujdeset për krijimin dhe organizimin e komisioneve dhe grupeve të punës dhe kontrollon veprimtarinë e tyre.
4. Organizon dhe drejton punën për hartimin e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, të rregulloreve për veprimtaritë e Këshillave të Urdhrit dhe Aparatit Qendror.
5. Organizon mbledhjet e Këshillit Kombëtar, të Bordit Këshillimor, të komisioneve e grupeve të punës, si dhe veprimtari të tjera.
6. Organizon marrëdhëniet publike dhe kontaktet me institucionet shtetërore dhe jo shtetërore të vendit, si dhe me organizata e forume ndërkombëtare.
7. Raporton dhe informon sistematikisht Presidentin dhe Këshillin Kombëtar lidhur me mbarëvajtjen e punës dhe detyrat specifike të Tij.
8. Organizon dhe drejton punën për daljen e Buletinit dhe kujdeset për botime të tjera.

Për mbulimin e këtyre detyrave, Sekretari i Përgjithshëm mbështetet tek Zëvendësi i tij/ Aparati Qendror, si dhe krijon grupe pune e komisione të ndryshme.

### **Neni 23** **Këshillat Rajonale**

Këshilli Rajonal është organi më i lartë drejtues dhe vendimmarrës i USSH të Rajonit midis dy mbledhjeve të Asamblesë Rajonale.

Shqipëria ndahet në 7 keshilla rajonale.

Këshilli Rajonal përbëhet nga:

- a- 5-7 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja Rajonale sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Statut. Këshilli Rajonal i Tiranës përbëhet nga 7-9 anëtarë.
- b- Anëtarë të kooptuar nga vetë këshilli për zëvendësim të anëtarëve që eventualisht janë larguar;

Këshilli Rajonal zgjedh Presidentin dhe Zëvendësin i tij. Mandati i Presidentit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje. Funkzioni i tyre është i papajtueshëm me funksione të tjera drejtuese të administratës shtetërore, apo forume drejtuese partiake.

Këshilli Rajonal emëron dhe shkarkon Sekretarin e tij, i cili duhet të jetë me arsim të lartë dhe preferohet mjek.

**Për të përmbushur funksionet e detyrat e tij Këshilli Rajonal:**

- 1- Krijon dhe mban të azhornuar Regjistrin e Mjekëve duke pasqyruar në të çdo ndryshim në karrierën e tyre profesionale,
- 2- Pajis stomatologët me Liçensën për ushtrimin individual të profesionit.
- 3- Siguron zbatimin e vendimeve dhe udhëzimeve të Këshillit Kombëtar apo të Aparatit Qendror të tij.
- 4- Kryen veprimtaritë për njohjen dhe ndërgjegjësimin e bashkësisë së stomatologëve të juridiksionit të vet me aktet normative, misionin, synimet, funksionet dhe detyrat e Urdhrit.
- 5- Analizon periodikisht veprimtaritë e Urdhrit dhe organizmave të tij në Rajon.
- 6- Bazuar në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor Profesional, organizon proceset disiplinore të shkallës së parë.
- 7- Sensibilizon dhe informon publikun për funksionin dhe kompetencat e Urdhrit, me veprimtari të drejtpërdrejta me kontigjente të publikut ose nëpërmjet mediave.
- 8- Krijon komisione apo grupe pune të përkohshme në përputhje me veprimtarinë e tij. Për këtë njofton paraprakisht Aparatin Qendror të Këshillit Kombëtar.
- 9- Përfaqëson dhe mbron interesat e anëtarësisë lidhur me të drejtën për ushtrimin e lire e të pavarur të profesionit mjekësor dhe deklaron publikisht opinionet e tij për ngjarje e situata të veçanta mjekësore në rajon brenda limiteve të misionit dhe të funksioneve të Urdhrit.
- 10- Organizon punën për mbledhjen e kuotizacioneve dhe të detyrimeve të tjera të anëtarëve.
- 11- Krijon marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e administratës shtetërore, me organizma jo qeveritare brenda rajonit, si dhe me organizata homologe të vendeve fqinje.
- 12- 1 propozon Presidentit të Këshillit Kombëtar për probleme e nisma që i quan të domosdoshme për të rritur standardet e shërbimit në rajonin e vet ose më gjerë.
- 13- Nxit dhe mbështet organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive studimore shkencore dhe kualifikuese të stomatologëve të rajonit dhe pjesëmarrjen e tyre në programet e Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor.
- 14- 1 propozon Këshillit ose Presidentit të Këshillit Kombëtar për dekorime, vlerësime, shpërblime, si dhe për ndihma në raste fatkeqësish për anëtarët e Urdhrit në juridiksion.
- 15- Kryesia e Këshillit Rajonal thërret stomatologe ose/dhe drejtues institucionesh kur ndaj tyre, apo shërbimeve që ata drejtojnë ka ankesë ose shprehje pakënaqësie, të cilët i njofton për sa sipër, i këshillon dhe sipas rastit relation ose i paralajmëron për gjykim disiplinor. Të gjitha këto pasqyrohen në Dosjen personale të stomatologut dhe protokolle të posaçme.

## **Neni 24**

### **Thirrja e Këshillave Rajonale**

Mbledhja e Këshillit Rajonal thirret nga Presidenti i këtij Këshilli, ose në mungesë të tij nga Zv. Presidenti. Mbledhjet e Këshillit bëhen një herë në 4 (katër) muaj 3 (tre) herë në vit. Mbledhja e jashtëzakonshme thirret nga Presidenti

i Këshillit Kombëtar, ose me miratimin e tij kur e kërkon Kryesia e Këshillit Rajonal.

## **Neni 25**

### **Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar dhe të Këshillave Rajonale.**

Kandidaturat për anëtarë të Këshillit Kombëtar dhe të këshillave rajonale zgjidhen ndër mjekët më të dalluar për përkushtimin, aftësi dhe autoritet profesional.

#### **Përzgjedhja bëhet duke u orientuar nga këto kritere më kryesore:**

- 1) Të jetë shtetas shqiptar.
- 2) Të ketë mbushur moshën 30 vjeç.
- 3) Të ketë mbi 5 vjet i regjistruar në Urdhrin e Stomatologeve
- 4) Të ketë reputacion etiko-moral dhe profesional.
- 5) Të ketë aftësi komunikuese dhe të ketë shfaqur korrektësi në zbatimin e normave dhe rregullave në jetën shoqërore, në komunikimin me publikun, pacientët, kolegët, si dhe me drejtuesit.
- 6) Të mos jetë ndëshkuar për vepra penale, si dhe gjatë 5 (pesë) viteve të fundit të mos jetë ndëshkuar për shkelje të ushtrimit të profesionit.
- 7) Të mos ketë funksione drejtuese në administratën shtetërore dhe të mos bëjë pjesë në forume drejtuese partiake të çdo niveli qofshin.

## **Neni 26**

### **Largimi i Parakohshëm nga Këshilli**

Anëtari i Këshilli Kombëtar dhe atij Rajonal largohet para kohe nga Këshilli kur:

1. Kërkon vetë dorëheqje;
2. Dënohet me vendim të formës së prerë për vepra penale apo për shkelje në ushtrimin e profesionit ose shkelje administrativo-disiplinore;
3. Shpërdoron detyrën;
4. Mungon më shumë se 3 (tre) herë në mbledhjet e Këshillit pa shkaqe të arsyetuara;
5. Paaftësohet për arsye shëndetësore;
6. Paraqet paaftësi në kryerje të detyrave;
7. Emërohet apo zgjidhet në detyra drejtuese shtetërore apo partiake që bien ndesh me kriteret e parashikuara në këtë Statut për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar dhe të Këshillave Rajonale.

## **Neni 27**

### **Propozimi dhe vendimmarrja për largimin e parakohshëm**

Përveç pikës 1, të nenit paraardhës, në të gjitha rastet, propozimin kanë të

drejtë t'ia paraqesin Këshilli përkatës:

A- Për anëtarët e Këshillave Rajonale:

- 1- 1/4 e asamblesë rajonale;
- 2- Jo më pak se 2 (dy) anëtarë të atij këshilli. Për Këshillin Rajonal të Tiranës, jo më pak se 3 (tre) anëtarë.
- 3- Presidenti i këshillit përkatës.

B- Për presidentët e këshillave rajonale:

- 1- 1/3 e asamblesë rajonale;
- 2- Jo më pak se 3 (tre) anëtarë të këshillit përkatës. Për Këshillin Rajonal të Tiranës, jo më pak se 4 (katër) anëtarë.
- 3- Presidenti i Këshillit Kombëtar.

C- Për anëtarët e Këshillit Kombëtar:

- 1- 1/3 e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme;
- 2- 1/3 e anëtarëve të Këshillit Kombëtar;
- 3- Presidenti i Këshillit Kombëtar.

D- Për Presidentin e Këshillit Kombëtar:

- 1- 1/3 e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme;
- 2- 1/3 e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

*Në të gjitha rastet për vendimmarrje është e domosdoshme:*

- a. Për Presidentin dhe anëtarët e Këshillit Rajonal, pjesëmarrja në mbledhje 100% e anëtarëve të Këshillit. Vendimi merret me shumicë të thjeshtë të votave.
- b. Për Presidentin dhe anëtarët e Këshillit Kombëtar, pjesëmarrja në mbledhje më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit. Vendimi merret me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.

Në të gjitha rastet votimi bëhet i fshehtë me përjashtim të rasteve kur vete Këshilli përkatës vendos të kundërtën.

Për rastet që i përkasin pikës 7 të nenit paraardhës, largimi është i detyrueshëm dhe nuk votohet.

Kur Këshilli Kombëtar vendos largimin e parakohshëm të një anëtari të tij, i cili njëkohësisht është President i Këshillit Rajonal, atëherë Këshilli Rajonal është i detyruar të zbatojë vendimin e Këshillit Kombëtar ahe detyrimisht zgjedh një president tjetër nga radhët e tij.

## **Neni 28**

### **Njoftimi për mbledhjet**

Presidenti (*në mungese Zëvendës i tij*) i Këshillit Kombëtar apo Rajonal vendos për datën, kohën dhe rendin e ditës së çdo mbledhje.

Mbledhja e Këshillit (Kombëtar apo Rajonal) njoftohet me shkrim 7-14 ditë përpara, duke bërë të ditur edhe rendin e ditës.

Kriteret e mësipërme mund të mos zbatohen vetëm në raste e rrethana të veçanta. Në çdo mbledhje duhettë jenë të pranishëm me shume se gjysma e anëtarëve të cilët paraprkishtë miratojnë rendin e ditës dhe zhvillimin e mbledhjes.

### **Neni 29**

#### **Marrja e vendimeve**

Këshilli (Kombëtar apo rajonal) merr vendim vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes përveç rasteve kur shumica e anëtarëve të pranishëm janë dakort për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve edhe për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

### **Neni 30**

#### **Vlefshmëria e mbledhjes**

Mbledhja e Këshillit (Kombëtar apo atij Rajonal) është e vlefshme kur janë të pranishëm me shumë se gjysma e anëtarëve. Kur në hapjen e mbledhjes kjo shumicë nuk arrihet, atëherë Presidenti apo zëvendësi që drejton mbledhjen, vendos thirrjen e mbledhjes një ditë tjetër, duke përsëritur njoftimin me shkrim.

### **Neni 31**

#### **Proçesverbali i mbledhjes**

Në çdo mbledhje mbahet një proçesverbal ku shkruhet data, vendi i mbledhjes, pjesëmarrësit, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma e rezultati i votimit.

Presidenti i Këshillit Rajonal apo Kombëtar cakton një person të përhershëm për mbajtjen e proçesverbalit.

Në mbarim të mbledhjes proçesverbali nënshkruhet nga mbajtësi (sekretari) dhe Presidenti i këshillit ose zëvendësi që ka drejtuar mbledhjen.

### **Neni 32**

#### **Forma e votimit**

- 1) Vendimet merren me votime të hapura, përveç rasteve kur me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm vendoset ndryshe.
- 2) Vendimet që përmbajnë vleresime mbi sjelljen ose cilësitë e nje individi merren me votim të fshehtë, përveç rasteve kur me shumicë votash vendoset ndryshe.

### **Neni 33**

#### **Vlefshmëria e votës për të marrë vendime**

Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Kur ka barazim të votave, kryhet një votim i dytë. Nëse edhe në votimin e dytë përsëritet e njëjta situatë, vota e Presidentit është vendimtare.

## ***Pjesa e dytë*** **Komisionet e Urdhrit**

### **Neni 34**

#### **Komisionet Disiplinore**

Pranë Këshillit Kombëtar dhe Këshillave Rajonale funksionojnë Komisionet Disiplinore.

Komisionet Disiplinore janë organizma të gjykimit disiplinor profesional të pavarur.

Ato verifikojnë dhe shqyrtojnë ankesat dhe kërkesat për shkelje të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, si edhe për kequshtrim profesioni dhe gabime mjekësore.

Komisionet Disiplinore pranë Këshillave Rajonale ushtrojnë kompetenca disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre mund të apelojnë në Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë dhe përfundimtare.

Këto Komisione Disiplinore funksionojnë në bazë të Rregullores së posaçme (Për Gjykimin Disiplinor P-rofesional) e miratuar nga Këshilli Kombëtar.

### **Neni 35**

#### **Anëtarët e komisioneve disiplinore**

Për të siguruar zhvillimin e një gjykimi profesional të pavarur, të drejtë dhe me kompetencë, përzgjedhja e anëtarëve të komisioneve disiplinore bëhet vetëm mbi bazën e kërkesave të larta cilësore dhe kritereve individuale të specifikuar në Rregulloren për Gjykimin Disiplinor Profesional.

### **Neni 36**

#### **Kompetencat ndëshkimore**

Komisioni Disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara në seancë dëgjimore. Kur vërtetohet së anëtari ka kryer shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, Ligjit dhe akteve të tjera kodifikuese lidhur me ushtrimin e profesionit, ai e shpall atë fajtor dhe i jep këto masa:

a) Vërejtje me shkrim;

- b) Vërejtje me paralajmërim;
- c) Gjobë, nga 1.000 — 100.000 lekë;
- ç) Propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore.
- d) Pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologeve deri në 3 (tre) vjet;
- dh) Përfundim i përkohshëm nga Urdhri i Stomatologeve për një periudhë deri në 3 (tre) vjet.

Masa ndëshkuese e parashikuar në shkronjën "dh" sjell si rrjedhojë ç'regjistrim nga Regjistri i Stomatologeve të Rajonit dhe ai Kombëtar, si dhe heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit për afatin e caktuar në Vendimin Disiplinor.

Masat e mësipërme disiplinore mund të shlyhen, në qofte se brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre për shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni, dhe brenda 3 (tre) vjetësh nga data e dhënies së tyre për shkronjat "ç", "d", dhe "dh", ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

### **Neni 37**

#### **Detyrimi për kualifikimin profesional**

Përveç masave ndëshkuese, për Stomatologet që nuk plotësojnë detyrimin e pjesëmarrjes në procesin e Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor dhe nuk fitojnë kreditet e domosdoshme, komisionet disiplinore vendosin edhe detyrime me afate të përcaktuara për kualifikimin e nevojshëm profesional dhe të studimeve plotësuese me provimet përkatëse. Këto detyrime specifikohen nga një Komision i ngritur në bashkëpunim me QKEV-në. Shpenzimet përkatëse përballohen nga anëtari i ndëshkuar disiplinarisht.

### **Neni 38**

#### **Shpenzimet për proceset disiplinore**

Të gjitha shpenzimet për proceset disiplinore të kryera, përballohen nga USSH -ja.

### **Neni 39**

#### **Ankimimi për vendimet disiplinore**

Ankimimi kundër vendimit për kalimin ose jo të ankesës në Komision Disiplinor nga ana e Këshillit Rajonal apo masave të marra nga Komisioni i Gjykimit Disiplinor të shkallës së parë bëhet në bazë të afateve të përcaktuara në Rregulloren për Gjykimit Disiplinor Profesional.

Për masat disiplinore të parashikuara në gërmat 'c', dhe 'dh' të nenit 35 të këtij Statuti, personi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës.



**Neni 40**  
**Komisione të tjera dhe grupe pune (ad-hoc)**

Pranë Këshillit Kombëtar dhe Këshillave Rajonale, në përputhje me probleme që lindin, krijohen komisione apo grupe pune të përhershme ose të përkohshme.

Veprimtaria e këtyre komisioneve bazohet në rregulloret përkatëse. Në pamundësi të ngritjes së Komisioneve apo të sektorëve të përhershëm, Aparati Qendror ngarkon me funksione të ndryshme individë nga Aparati, ose emëron të tjerë me kohe të plotë apo të reduktuar në punë (honorifik).

***Pjesa e tretë***  
**Financat**

**Neni 41**  
**Buxheti**

Urdhri i Stomatologeve ka buxhetin e tij, të cilin e administron vetë në përputhje me Ligjin "Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë", si dhe me rregulloren përkatëse. Burimet financiare të Urdhrit të Stomatologut janë:

- a) Kuotizacionet e anëtarëve;
- b) Tarifat e regjistrimit dhe të dhënies së Liçensës për ushtrimin individual të profesionit.
- c) Donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme

Të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Urdhri i Stomatologeve i përdor për të përmbushur misionin e tij të caktuar në Ligjin për Urdhrin e Stomatologeve ve dhe në këtë Statut.

Financiare pranë Aparatit Qendror.

Veprimtaria e Degës Ekonomike-Financiare kryhet në përputhje me rregulloren e posaçme për këtë sektortë miratuar nga Këshilli Kombëtar.

**Neni 42**  
**Kuotizacionet**

1. Kuotizacioni mujor për anëtarët është i detyrueshëm. Masa e kuotizacionit përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar.
2. Kur për një periudhë prej më shumë se një viti nuk shlyen kuotizacionet dhe nuk

paraqet arsye të justifikueshme, i pezullohet anëtarësimi në USSH dhe Liçensa për ushtrimin individual të profesionit.

### **Neni 43** **Përdorimi i burimeve financiare**

Burimet financiare të Urdhrit përdoren për:

- a) Paga dhe honorare, ndihma në rast fatkeqesie për anëtarët dhe familjet e tyre, shpërblime për anëtarët e Urdhrit, komisionere, ekspertë, grupe pune, si dhe për punonjësit e Aparatit.
- b) Aktivitete të ndryshme kulturore.
- c) Kontributin për sigurimet shoqërore e shëndetësore të punonjësve.
- d) Detyrimet me shtetin dhe të tretët, etj.
- e) Shpenzimet operative (kancelari, transport, ndërlidhje, energji, dieta, dokumentime fotografike, audiokaseta dhe videokaseta e të tjera).
- f) Organizim veprimtarish shkencore-profesionale e kualifikuese (konferenca, simpoziume, sesione, seminare, trajnime, etj.).
- g) Botime me karakter shkencor dhe informativ e promovues për Urdhrin.
- h) Investim dhe blerje mjetesh dhe pajisjesh pune.
- i) Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombetare, si dhe pritje e përcjellje delegacionesh të huaja.
- j) Ceremoni të ndryshme përkujtimore, promovuese, etj.

## **KREU I KATERT**

### **Dispozita përfundimtare Neni 44 Emërtimi**

Emri i organizmit është ***"URDHRI I STOMATOLOGEVE TË SHQIPËRISË"***

### **Neni 45** **Stema dhe vula**

Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë ka stemën dhe vulën e tij (Këshilli Kombëtar dhe Këshillat Rajonale).

### **Neni 46** **Rezidenca**

Rezidenca e Këshillit Kombëtar është në Tiranë.

### **Neni 47** **Llogaria bankare**

USSH-ja mban llogari bankare në lekë dhe në valutë të huaj.

**Neni 48**  
**Organi periodik**

USSH-ja nxjerr Organin e tij periodik: ***“BULETINI I URDHRIT TË STOMATOLOGUT TË SHQIPËRISË”***.

***Miratuar ne mbledhjen e keshillit kombetar ne daten 14.04.2015 ne ambientet e ministrise se shendetesise Tirane.***

**PRESIDENTI**  
**Dr. N ikoll Deda**